



## **STUDIMI GJEOLOGJIK**

### **1-HYRJE.**

Ne kete raport po paraqesim vlersimin e rezultateve te studimit gjeologo-inxhinerik te sheshit te ndertimit te teritorit te stacionit te trenit Lezhe, mbeshtetur ne studimet gjeologo-inxhinerike te kryera me pare ne afersi te sheshit te ndertimit.

Qellimi i studimit te kryer ka qene:

- Njohja e ndertimit gjeologo-litologjik te sheshit.
- Vetite fiziko-mekanike te dherave te ndara ne shtresa, per te gjitha prerjen, nga siperfaqeja e tokes natyrale deri ne thellesine 6.0 m.

Ky studim ti sherbeje projekt-zbatimit, per rikonstrukcionin dhe sistemimin e sheshit ekzistues te stacionit te trenit. Per realizimin e ketij studimi ne jemi mbeshtetur tek:

- 1-Studimi i materialeve arshivale te studimeve te meparshme gjeologo-inxhinerike, te kryera ne afersi te sheshit te ndertimit, nga autore te tjere te ketij specialiteti.
- 2-Vrojtime siperfaqesore te fenomeneve fiziko-gjeologjike si brenda sheshit te ndertimit ashtu dhe per rreth tij.

### **2-Pozicioni dhe ndertimi gjeologjik i sheshit.**

Sheshi i ndertimit ndodhet ne qytetin e Lezhes, ne nje distance rreth 150 ne jug-lindje te mbikalimit te rruges nacionale Lezh-Shkoder. Persa i perket ndertimit gjeologjik sheshi ka nje ndertim te thjeshte. Depozitimet me te vjetra jane Cr<sub>2</sub>+P<sub>g</sub>1-2 te perbere nga flishi alevrolito-ranoro-mergelore dhe gelqerore, qe ne sheshin e studiuar nuk kane dalje ne siperfaqe. Mbi keto depozitime jane te vendosura depozitimet e kuaternarit , me origjine detare dhe aluviale te lumit.



### **3-Kushtet gjeologo-inxhinerike te sheshit te ndertimit.**

Si bazament per rojektit te propozuar per rikonstruksion, do te sherbejne depozitimet e aluviale te kuaternarit.

Duke u mbeshtetur ne te dhenat e studimeve gjeologo-inxhinerike te kryera nder vite ne afersi te sheshit te ndertimit, kemi vecuar dy shtresa, me veti fiziko-mekanike te ndryshme.

Me poshte ne menyre te detajuar po japim cdo shtrese, pershkrimin litologjik dhe vetite fiziko-mekanike.

**(Shtresa-1)** Perfaqesohet nga depozitimet aluviale te kuaternarit dhe perbehet nga suargjila te lehta deri ne surane e rende, pluhurore, me ngjyre kafe, me lageshti, plastike deri plastike te buta, pak deri mesatarishte te ngjeshura. Kjo shtrese gjendet ne thellesine 5.0m nga siperfaqeja e tokes natyrale.

Vetit fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja granulometrike.

|                                     |                        |
|-------------------------------------|------------------------|
| Fraksioni ranor .....               | 28.6%                  |
| Fraksioni pluhuror.....             | 61.5%                  |
| Fraksioni argjilor.....             | 9.9%                   |
| Lageshtia natyrale.....             | 26.1%                  |
| Kufiri i siperm i plasticiteti..... | 27.0%                  |
| Kufiri i siperm i poshtem.....      | 20.4%                  |
| Numri i plasticitetit.....          | 6.6                    |
| Pesha vellimore .....               | 1.89gr/cm <sup>3</sup> |
| Pesha e skeletit .....              | 1.49gr/cm <sup>3</sup> |
| Pesha specifike.....                | 2.70gr/cm <sup>3</sup> |
| Moduli i kompresionit .....         | 60.7kg/cm <sup>2</sup> |
| Kendi i ferkimit te brendshem.....  | 18 <sup>0</sup>        |
| Ngarkesa e lejuar .....             | 1.6 kg/cm <sup>2</sup> |
| CBR.....                            | 6-8%                   |



**(Shtresa-2)** Perfaqesohet nga depozitimet detare te kuaternarit te perbera nga Surere e lehte me breza te holle suargjilash, me ngjyre bezhe, me lageshti, me plasticitet te dobet, pak deri mesatarisht te ngjeshura.

Vetite fiziko-mekanike per kete shtrese jane:

Perberja granulometrike.

|                                     |                        |
|-------------------------------------|------------------------|
| Fraksioni ranor .....               | 36.7%                  |
| Fraksioni pluhuror.....             | 57.0%                  |
| Fraksioni argjilor.....             | 6.3%                   |
| Lageshtia natyrale.....             | 26.1%                  |
| Kufiri i siperm i plasticiteti..... | 28.0%                  |
| Kufiri i siperm i poshtem.....      | 20.4%                  |
| Numri i plasticitetit.....          | 7.6                    |
| Pesha vellimore .....               | 1.86gr/cm <sup>3</sup> |
| Pesha e skeletit .....              | 1.49gr/cm <sup>3</sup> |
| Pesha specifike.....                | 2.70gr/cm <sup>3</sup> |
| Moduli i kompresionit .....         | 60.7kg/cm <sup>2</sup> |
| Kendi i ferkimit te brendshem.....  | 18 <sup>0</sup>        |
| Ngarkesa e lejuar .....             | 1.5 kg/cm <sup>2</sup> |

**Ing. Ramazan Myrto**